



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1057/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Sh.p.k Eurotec-Baron në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Fazliu, avokat në Prishtinë, kundër debitorit Sh.p.k, Baron, me NRB:811185570, me adresë rr. “Lidhja e Pejës”, pn në Gjilan, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, CPK.204/21 i datës 16.06.2022, me datë 08.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit Sh.p.k Eurotec-Baron në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, CPK.204/21 i datës 16.06.2022, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, CPK.204/21 i datës 16.06.2022, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar propozimin e Përbaruesit Privat Destan Bujupaj nga Prishtina me të cilin ka kërkuar që debitori si person juridik Sh.p.k, “Baron” të dënohet me gjobë për moszbatim të Pajtitimit Gjyqësor të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IEK.Nr. 134/18 të dt.01.10.2020 i bërë i përfundueshëm me datën 01.10.2020 si dhe i ekzekutueshëm me datën 03.11.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Sh.p.k Eurotec-Baron në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar.

Debitori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, CPK.204/21 i datës 16.06.2022.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën

Përmbaremore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

### **Ankesa e kreditorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit në bazë të titullit përmbareimor- Pajtimi Gjyqësor IEK nr.134/2018 i datës 01.10.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, i plotfuqishëm me datën 01.10.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.11.2020.

Përmbareusi privat, ka lejuar përmbareimin me urdhrin përmbareimor P.nr.1114/20 të datës 09.11.2020.

Kundër këtij urdhri përfaqësuesi i debitorit Av Ymer Huruglica ka ushtruar parashtrësë me datën 15.03.2021 me të cilën e ka njoftuar gjykatën se debitori ka vepruar sipas pajtimit gjyqësor dhe para datës 01.11.2020 e ka hequr markën tregtare.

Me datën 10.12.2021, Përmbareusi Privat ka ushtruar një shënim zyrtar-propozim për shqiptimin e gjobës duke shtuar se debitori nuk ka vepruar sipas titullit përmbareimor dhe nuk e ka ndaluar përdorimin e paautorizuar e markës tregtare “Baron” dhe largimin e së njëjtës nga hapësirat e biznesit të tij. Në fund gjykatës i ka propozuar që të inicoj procedurën përmbareimore për shqiptimin e gjobë konform nenit 15 dhe 16 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës se parë ka gjetur se propozimi i përmbareusit privat Destan Bujupaj nga Prishtina duhet refuzuar për dënimin me gjobë për arsye debitori ka vepruar sipas pajtimit gjyqësor IEK nr.134/18 të datës 01.11.2020 duke e hequr markën tregtare që e ka përdorur deri në ditën e arritjes së këtij pajtimi me datën 01.11.2020.

Gjykata Komerciale vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), neni 183 dhe 184 të LPK-së, lidhur me nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet meqë dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten si dhe me arsyetimin e aktvendimit. Në aktvendimin e atakuar ekzistojnë fakte vendimtare në kundërthënie midis asaj që në dispozitiv të aktvendimit thuhet për përmbajtje të dokumentit.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar propozimin e përmbareusit privat Destan Bujupaj nga Prishtina për dënimin me gjobë për arsye debitori ka vepruar sipas pajtimit gjyqësor

IEK nr.134/18 të datës 01.11.2020 duke e hequr markën tregtare që e ka përdorur deri në ditën e arritjes së këtij pajtimi me datën 01.11.2020.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente në rast se debitori nuk vepron sipas pajtimit gjyqësor të arritur mes palëve. Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur të vlerësoj nëse titullit përmbartimor- Pajtimi Gjyqësor IEK nr.134/2018 i datës 01.10.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 22 par 1.1 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, nëse dokumenti përmbartues është në origjinal apo kopje vërtetuar me klauzolën e përmbartueshmërisë, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin përmbartimor nëse i njëjti sipas dispozitave ligjore i plotëson kushtet si dokument përmbartues, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkalles se Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1057/23, me datë 08.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**